



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-38865

Dt. 26.08.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e Byrhan Kubati nga Prizreni në bazë të neneve 3alineja 1 pikat 1.1,1.4 ,1.11,1.16, 1.17,1.20,1.24 dhe të nenit 4 alineja 1 pika 1.2 ,e lidhur me nenin 5 alineja 1 pika 1.4 si dhe nenit 14.alineja 1 pika 1.5 si dhe ne lidhje me nenin 15 pika 1.1 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, dhe në harmoni me dispozitat e nenit 3 alineal pikat 1.1,1.3,1.5,1.6,1.7,dhe 1.8 e lidhur me nenet 4,5, dhe 9 dhe 11të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 ,si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e Parë e Mbrojtjes nr.01/011—6604 të dt.18.12.2008 , nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 13,14,44,45,46,47,124 e në lidhje me nenin 125 LPA-së nr. 05/L-031, merr këtë:

VENDIM

- I. **LEJOHET:** Byrhan Kubati në zhvillimin e punimeve në nderimin e kulmit dhe renovimin e shtëpis individuale për banim me lokal në përdhese me etazhitet egzistuese B+P+2+Nk. në ngastrën kadastrale P-71813068-02286-2 ZK Prizren në rrugën “Saraqët”.
- II. Gjatë implementimit të projektit nuk lejohet kurrfarë zgjerimi në gabarit dhe etazhitet .
- III.Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.
- IV.Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Vendimi i QRTK nr. 247/2 dt. 11.07.2024 dhe Rekomandimi i KTKQH Prizren të dt. 10.07.2024.
- V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.
- VI. Pas kryerjes së punimeve shfrytëzuesi obligohet të pastroj vend punishten.

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se:


Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional, të Komunës së Prizrenit.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes në zhvillimin e punimeve në nderimin e kulmit dhe renovimin e shtëpis individuale për banim me lokal në përdhese me etazhitet egzistuese B+P+2+Nk. në ngastrën kadastrale P-71813068-02286-2 ZK Prizren në rrugën "Saraqët".

Nga se u tha më lartë u murr aktvendimi si në dispozitiv.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës , përmes këtij organi.

Bashkëpunëtor profesional:



Afërdita Mormorina, inxh.dipl.ark.

DREJTORI



Pranverim Berisha, jur.

